

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	02.06.2023	Drejtuar: Qendra Kombëtare e Kinematografisë Për dijeni: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale Lënda: Kërkesë për informacion Zoti Kryetar, në vendimin tuaj lidhur me financimet e festivaleve, mësuam se festival! DEA OPEN AIR International Film Festival, nuk do të financohet në edicionin e tij të dhjetë !!! Përpara se të ndjekim rrugën ligjore, bazuar në Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 3 pika 1 “E drejta për informim”, kërkojmë prej jush të na vendosni në dispozicion : 1.Kriteret e vendosura për vlerësimin e festivaleve të filmit. 2.Dokumentacionin e plotë të procesit të vlerësimit. 3.CV profesionale të anëtarëve të KPM që kanë vlerësuar projektin. 4.Raportet e vlerësimeve (auditimit) të festivaleve në vite. E**** T****	07.06.2023	Lënda: Kthim përgjigje Drejtuar: Z. E***** T**** Drejtor dhe themelues i ***** Për dijeni: Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale Zoti T*****, Në datën 02.06.2023 ka mbërritur shkresa “Kërkesë për informacion”, në të cilën kërkon t’ju vendoset në dispozicion informacion lidhur me: “ 1. Kriteret e vendosura për vlerësimin e festivaleve të filmit. 2. Dokumentacionin e plotë të procesit të vlerësimit. 3. CV profesionale të anëtarëve të KMP që kanë vlerësuar projektin. 4. Raportet e vlerësimeve (auditimit) të festivaleve në vite.” Së pari, dëshirojmë të theksojmë se kërkesa juaj duhet të përcillet nëpërmjet shtëpisë kinematografike ***** , e cila këtë vit ka marrë përsipër realizimin e festivalit, duke paraqitur aplikimin dhe kërkesën për mbështetje financiare pranë QKK dhe	E PLOTË	PA PAGESË

		Drejtore dhe themelues *****	Këshillit të Miratimit të Projekteve. Ky subjekt, në dokumentacionin e aplikimit ka paraqitur edhe Deklaratën e Shtëpisë Kinematografike, në pikën 2 të të cilit, nën përgjegjësi personale ka deklaruar “3. Pranoj si të padiskutueshëm rezultatin e vendimmarrjes së KMP, në rast se projekti nuk kualifikohet për financim.”, (Deklarata bashkëlidhur). Së dyti, ashtu sikundër edhe Ju e dini, përbërja e Këshillit të Miratimit të Projekteve është e njëjtë si ajo e vitit 2022, ku u vendos dhënia e mbështetjes financiare për ***** , ku ju aplikuat me shtëpinë kinematografike ***** , administrator i së cilë jeni. Së treti, për sa i përket deklaratës suaj të bërë në mënyrë publike në murin Facebook të QKK, (dokumenti 2 bashkëlidhur), shprehemi se është një deklaratë mjerane, e cila përbën një turp të madh publik për ju si shkruar i saj. Niveli i kësaj deklarate është në shkelje të kodit etik e moral si nga përmbajtja, po ashtu dhe për nga niveli kulturor dhe intelektual. Parimi i çdo konkurimi është që jo të gjithë pjesëmarrësit në garë shpallen fitues. Çdokush është i lirë të shprehë vlerësime, apo pakënaqësi për rezultatet, por duhet të dijë t’i menaxhojë emocionet si në humbje, ashtu edhe në fitore në mënyrë etike dhe morale.		
--	--	--	---	--	--

				Sa më lart, kërkojmë nga ju të ndaloni menjëherë, fyerjet dhe shkeljen e dinjitetit për anëtarët e Këshillit të Miratimit të Projekteve dhe stafin e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë. Në rast të kundërt do të përballeni me reagimin institucional sipas ligjeve në fuqi. Ju falënderoj për mirëkuptimin. Eduart Makri Kryetar		
2	16.06.2023	Drejtuar: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale - Rruga e Kavajës Nd.80, H.I, Tiranë Avokati i Popullit - Blv. "Zhan D'Ark", Nr. 2, Tiranë Për dijeni: Qendra Kombëtare e Kinematografisë Lënda: Ankim administrativ për shkelje të së drejtës së informimit sipas ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 3, pika 1 Të nderuar zonja dhe zotërinj, në vijim të kërkesës sime për informacion, drejtuar Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, më datë 02.06.2023, për të cilën është vënë në dijeni edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, Ju drejtohem sot me këtë „ankim administrativ", me objekt „shkeljen e së drejtës së informimit"	29.06.2023	Lënda: Lidhur me Ankimin Administrativ për shkelje të së drejtës së informimit sipas ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 3, pika 1, të bërë nga z. E***** T*****, Drejtor dhe themelues i ***** Drejtuar: Z. Besnik DERVISHI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, Rruga e Kavajës Nd.80, H.I, Tiranë Znj. Erinda BALLANCA, Avokat i Popullit, Blv. "Zhan D'Ark", Nr. 2, Tiranë Për dijeni: Z. E***** T***** Drejtor dhe themelues i ***** Rruga ***** , Tiranë Të nderuar,	E PLOTË	PA PAGESE

		sipas ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 3 pika 1, me argumentimin vijues: 1. QKK nuk dha informacion lidhur me „kriteret e vendosura për vlerësimin e festivaleve të filmit" 2. QKK nuk vuri në dispozicion „dokumentacionin e plotë të procesit të vlerësimit të festivaleve të filmit". 3. QKK nuk vuri në dispozicion „CV-të profesionale të anëtarëve të KPM, që kanë vlerësuar projektin", mbi bazën e të cilave ata janë kualifikuar, si mjaftueshëm të specializuar për të vlerësuar standardet e një festivali filmi. 4. QKK nuk vuri në dispozicion “raportet e vlerësimeve (auditimit) të festivaleve të filmit në vite”. 5. Përgjigja formale e QKK-së, nr. 249/1 prot., dërguar për dijeni edhe Komisionerit, në të cilën theksohet, se “sëpari, ... kërkesa ... duhet tëpërcillet nëpërmjet shtëpisë kinematografike *****”, e cila këtë vit ka marrë përsipër organizimin e festivalit... ” dhe “së dyti..., përbërja e Këshillit të Miratimit të Projekteve është e njëjtë si ajo e vitit 2022, ku u vendos dhënia e mbështetjes financiare për *****...” përmban vetëm përpjekje për të Justifikuar dhe fshehur refuzimin e informacionit të kërkuar. 6. Të dhënat e kërkuara nuk mund t’i siguroja në rrugë tjetër, pasi Programi i Transparencës, i verifikuar në faqen e zyrtare të QKK më datë 16.06.2023, ora		Në adresë të institucioneve që Ju drejtoni, në datën 16.06.2023, z. E***** T*****, Drejtor dhe themelues i ***** , ka përcjellë ankim administrativ për shkelje të së drejtës së informimit sipas ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 3, pika 1. Lidhur me këtë ankim shprehemi: Në datën 02.06.2023, z. E***** T*****, në cilësinë e Drejtorit dhe themeluesit të ***** , ka paraqitur në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë dhe për dijeni Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, kërkesë për informacion sa më poshtë: “...kërkojmëprejush të na vendosni në dispozicion: 1. Kriteret e vendosura për vlerësimin e festivaleve të filmit. 2. Dokumentacionin e plotë të procesit të vlerësimit. 3. CV profesionale të anëtarëve të KPM që kanë vlerësuar projektin. 4. Raportet e vlerësimeve (auditimit) të festivaleve në vite. Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka dërguar përgjigje për këtë kërkesë në datën 07.06.2023 (bashkëlidhur). Në përgjigje nuk kemi refuzuar dhënien e informacionit, përkundrazi kemi dhënë shpjegimet e nevojshme. Megjithatë në pikën 2 të kërksave të tij	
--	--	--	--	--	--

		10.00, evidenton mangësitë e poshtëshënuara: - Dokumenti i fundit, i miratuar përputhur me detyrimet për transparencë, sipas ligjit 119/2014 (vërtetësia nuk mund të verifikohet pasi dokumentit të publikuar i mungon data dhe numri i protokollit) i takon vitit 2015 - E dhëna e fundit në rubrikën “Monitorimi i buxhetit” i takon tremujorit të dytë të vitit 2020 - E dhëna e fiindit në rubrikën “Fakte dhe shifra” u takon projekteve filmike, të financuara në vitin 2021 - Regjistri i kërkesave për informacion është bosh - Të dhënat e publikuara në rubrikën “Komisionet dhe Këshillat e miratimit të projekteve” kufizohen vetëm tek emrat e anëtarëve - Të dhënat, që përmban dokumentacioni i publikuar në rubrikën “Akte administrative të Kryetarit të QKK” kanë karakter thjesht statistikor dhe jo përmbajtësor. Nisur nga sa më sipër, ankohe - për shkeljen e së drejtës sime për informim, sipas ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 3, “E drejta e informimit”, pika 1 dhe - shkeljen e ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në nenin 3, “E drejta e informimit”; nenin 4, “Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës”;	z. T**** ka kërkuar “Dokumentacionin eplotë tëprocesit të vlerësimit”, i cili është një material konfidencial, që i jepet Shtëpisë kinematografike/Producentit që aplikon projektin për konkurim, i kemi kërkuar që këtë kërkesë ta paraqesë z. E***** M*****, përfaqësues i shtëpisë kinematografike *****, si subjekti aplikues i projektit. Pas përgjigjes së përcjellë nga ana jonë në datën 07.06.2023, z. T**** dërgon një e-mail, “Përgjigje për mospërgjigjen”, në datën 16.06.2023, drejtuar Kryetarit të QKK (dokumenti bashkëlidhur). E-maili përmban gjuhë tepër fyese dhe mungesë etike të theksuar, duke përbaltur institucionin dhe titullarin e tij. Për transperencë, në zbatim të të drejtës për informim, më poshtë ju paraqesim të gjitha argumentat lidhur me kërkesën për informacion të datës 02.06.2023: 1. Kriteret e vendosura për vlerësimin e festivaleve të filmit. Kriteret e vlerësimit të përojeteve kinematografike për festival filmi janë të përcaktuara në Fletën e votimit për këtë kategori, e cila është e publikuar në faqen e internetit të QKK http://nationalfilmcenter.gov.al/index.php/juridik/fletet-e-votimit/. Kriteret e vlerësimit për projektet “Festivale filmi” janë si më poshtë:		
--	--	--	--	--	--

		nenin 5, “Rishikimi i programit të transparencës; nenin 6, “Programet model të transparencës”, nenin 7, “Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë”; nenin 8, “Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve” - shkelje të ligjit 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 5, “Parimi i transparencës”, nenin 13 “Parimi i drejtësisë dhe paanësisë”, nenin 15 “Parimi i përgjegjësisë” dhe nenin 17 “Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit”, pika 2, nenin 23 “Verifikimi i kompetencës”, pika 1, dhe kërkoj ndjekjen dhe administrimin e këtij ankimi, sipas: - ligjit 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, Kreu V, “Shkeljet administrative dhe Sanksionet”, neni 18, “Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet” - ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005, shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 155/2014, datë 27.11.2014 “Për Avokatin e Popullit”, neni 19 - ligjit 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” Për angazhimin Tuaj, Ju falënderoj paraprakisht! E***** T***** Drejtore dhe themelues *****		1-Përshkrimi i projektit dhe platforma e paraqitur. 2-Shënimet e producentit për realizimin e projektit. 3-Mbështetje financiare publike vendase dhe / ose të huaja, të siguruar paraprakisht. 4-Performanca në edicionin e mëparshëm (mbulimi mediatik, impakti në publik dhe në rrjetet sociale, si dhe mbështetje të siguruar nga institucione publike dhe / ose private).” 2.Dokumentacionin e plotë të procesit të vlerësimit. Dokumentacioni i procesit të votimit është i përbërë nga fletët e votimit. Në kontratën që institucioni ka nënshkruar me anëtarët e Këshillit të Miratimit të Projekteve është e parashikuar që fletët e votimit janë kofidenciale dhe nuk publikohen për publikun. Kjo bëhet me qëllim që të mos cenohet integriteti në votim i anëtarëve të Këshillit të Miratimit të Projekteve. Në dispozicion të subjekteve aplikuese është Procesverbali i Komisionit të Evidentimit të pikëve, i cili është vënë on line dhe pasqyron renditjen e projekteve sipas rezultatit të vlerësimit, http://nationalfilmcenter.gov.al/index.php/keshillat-miratuese-te-projekteve/vendime-te-kmp-per-vitin-2023/. Gjithësesi,	
--	--	---	--	---	--

				përproducentët e interesuar, Qendra vë në dispozicion tabelën e mëposhtme ku përfshihen vlerësimet për të gjithë elementët e projektit: Ju falënderoj për mirëkuptimin. Eduart Makri Kryetar		
3	21.06.2023	E nderuar QKK, ju kërkoj një informacion të hollësishëm për rezultatin e votimit mbi bashkëprodhimet minoritare, ku shtëpia filmike ***** paraqiti projektin “Si krime dhe kundravajtje”, Në pritje, ju falenderoj për mirëkuptimin. Me respekt, A***** B***** Administratore e *****	26.06.2023	Lënda: Kthim përgjigje Drejtuar: Znj. A***** B***** Shtëpia kinematografike ***** Zonja B*****, Në përgjigje të kërkesës Tuaj me e-mail regjistruar në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë nr. 280 Prot., date 21.06.2023 ku kërkon “një informacion të hollësishëm për rezultatin e votimit mbi bashkëprodhimet minoritare, ku shtëpia filmike ***** paraqiti projektin “Si krime dhe kundravajtje”, Ju bëj me dije sa më poshtë: Në datën 12.06.2023, Këshilli i Miratimit të Projekte të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë përfundoi vlerësimin on line për kategorinë Film artistik me metrazh të gjatë Minority Co-production. Një ndër projektet e vlerësuara ishte edhe projekti “Si krime dhe kundravajtje”, skenari ***** , ***** , ***** regjia ***** , paraqitur nga shtëpia kinematografike ***** Komisioni i	E PLOTË	PA PAGESË

			evidentimit të vlerësimit të projekteve kinematografike pasi kreu procedurën e nevojshme, konstatoi se për projektin për film Film artistik me metrazh të gjatë Minority Co-production “Si krime dhe kundravajtje”, janë dhënë këto vlerësime me pikë: <table><tr><td colspan="2">Anëtari 1</td><td colspan="2">Anëtari 2</td></tr><tr><td colspan="2">Anëtari 3</td><td colspan="2">Anëtari 4</td></tr><tr><td colspan="4">Totali</td></tr><tr><td colspan="2">Vlerësimi për skenarin</td><td colspan="2">38</td></tr><tr><td>11</td><td>28</td><td>38</td><td>115</td></tr><tr><td colspan="2">Vlerësimi për regjisorin</td><td colspan="2">28</td></tr><tr><td>13</td><td>18</td><td>25</td><td>84</td></tr><tr><td colspan="2">Vlerësimi për produksionin</td><td>27</td><td>8</td></tr><tr><td>23</td><td>25</td><td>83</td><td></td></tr><tr><td colspan="2">Totali për çdo vlerësim</td><td colspan="2">93</td></tr><tr><td>32</td><td>69</td><td>88</td><td>282</td></tr></table> Në përfundim rezulton se projekti “Si krime dhe kundravajtje” ka marrë 282 pikë në total, duke u renditur në vendin e nëntë në klasifikim. Qendra Kombëtare e Kinematografisë, bazuar në fondin në dispozicion për këtë kategori projektesh, si dhe vlerësimit financiar të bërë nga KMP vendosi të mbështesë financiarisht pesë projekte. Informacioni që merrni nëpërmjet kësaj shkrese është konfidencial, ndaj lutemi të moskeqpërdoret nga ana Juaj. Duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj. Eduart Makri	Anëtari 1		Anëtari 2		Anëtari 3		Anëtari 4		Totali				Vlerësimi për skenarin		38		11	28	38	115	Vlerësimi për regjisorin		28		13	18	25	84	Vlerësimi për produksionin		27	8	23	25	83		Totali për çdo vlerësim		93		32	69	88	282	
Anëtari 1		Anëtari 2																																														
Anëtari 3		Anëtari 4																																														
Totali																																																
Vlerësimi për skenarin		38																																														
11	28	38	115																																													
Vlerësimi për regjisorin		28																																														
13	18	25	84																																													
Vlerësimi për produksionin		27	8																																													
23	25	83																																														
Totali për çdo vlerësim		93																																														
32	69	88	282																																													

				Kryetar		
--	--	--	--	---------	--	--